



# A doni të merrni pjesë në punën e Parlamentit gjerman?

## Bundestagu Gjerman

ju fton  
së bashku me:  
Freie Universität Berlin  
Humboldt-Universität zu Berlin  
Technische Universität Berlin  
me

## Bursën Ndërkombëtare të Parlamentit (IPS)

për pesë muaj në Berlin



IPS u drejtohet të rejave dhe të rinjve me kualifikim të lartë dhe me interes politik, të cilët kanë vullnetin të formësojnë në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi të ardhmen demokratike të vendit të tyre.

Bundestagu Gjerman, Parlamenti gjerman, u jep të rinjve mundësinë, që gjatë një veprimtarie prej 15 javësh pranë një anëtari (deputeti) të Bundestagut gjerman, të njohin sistemin parlamentar gjerman dhe proceset politike vendimore, si dhe që të mbledhin përvoja praktike në fushën e punës parlamentare.

Bursistët zgjidhen nga një komision i pavarur seleksionues i Bundestagut Gjerman.

### Kushtet:

- nënshtetësi kosovare
- studime universitare të përfunduara
- njohuri shumë të mira të gjuhës gjermane
- më i ri/e re se 30 vjeç në kohën e fillimit të bursës

### Bursa:

- 450 EURO në muaj
- strehimi falas
- marrje përsipër e shpenzimeve për sigurimet dhe udhëtimet

**Data e fundit për aplikimet: 30 qershor**

Informacione të mëtejshme mund të mësoni në anën e pasme të kësaj letre, në Ambasadën Gjermane ose në Internet, te adresa: